

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Studimet Master – Kontratat dhe e Drejta Komerciale

ABSTRAKT

Tema: Aftësia juridike dhe e veprimit e subjekteve të së drejtës civile me vështrim në efektin e kryerjes së punëve juridike dhe fitimin e të drejtave civile

Në këtë punim sqarohet aftësia juridike dhe ajo e veprimit tek subjektet e së drejtës, përkatësisht tek personat fizik dhe juridik, me theks të veçantë se si aftësia e tyre demonstron në kryerjen e punëve juridike dhe në fitimin e të drejtave civile. Punimi vë në pah se ideja dhe nevoja e subjektivitetit të personave fizik dhe juridik ka lindur qysh në kohërat e lashta, ndërsa zhvillimi i tij është në zhvillim edhe sot. Përkundër që personat fizik dhe juridik kanë subjektivitet të plotë, ajo dallon dukshëm si për nga koha dhe mënyra e fitimit, ashtu edhe tek kufijtë e shtrirjes së subjektivitetit.

Dallimet në subjektivitetin juridik, padyshim që reflektohen edhe tek fitimi i të drejtave civile dhe kryerja e punëve juridike, përderisa personat fizik mund të kryejnë punë juridike dhe mund të fitojnë të drejta subjektive civile gati në mënyrë të pakufizuar, kjo nuk është e njëjtë edhe tek personat juridik. Punimi vë në pah se personat juridik mund të kryejnë punë juridike dhe mund të fitojnë të drejta subjektive civile vetëm deri në kufijtë e veprimtarisë së tyre.

Përfundimisht, punimi sqaron në mënyrë unike subjektivitetin juridik, të subjekteve të së drejtës duke shpjeguar çdo dallim dhe karakteristik të tyre posaçërisht sa u përket fitimit të të drejtave civile dhe kryerjes së punëve juridike.

Fjalët kyçe: Person fizik, person juridik, aftësi juridike, aftësi e veprimit, punë juridike, të drejta civile.

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Haxhi Gashi

Kandidatja: Emine Haliti